

DEKLARATË

Për Mbrojtjen e Lumit Vjosë



Lumi Vjosa në vendin tonë është një ndër lumenjtë e fundit në gjendje natyrore në Evropë. Për më shumë se 270 km ai rrjedh i paprekur dhe i pandërprerë. Lumi është i karakterizuar nga kanione të bukur, në rrjedhën e sipërme dhe ka një shtrat të gjerë e madhështor në rrjedhën e mesme e të poshtme. Së bashku me degët e saj, Vjosa krijon një ekosistem dinamik, një trashëgimi të vërtetë të natyrës evropiane. Në të njëjtën kohë, Vjosa është një nga lumenjtë më pak të njohur të Evropës. Të dhënat ekologjike dhe hidromorfologjike për të janë jashtëzakonisht të kufizuara.

Megjithatë, përgjatë rrjedhës në Shqipëri, janë parashikuar të ndërtohen rreth 8 diga hidrocentralesh. Një prej tyre, ajo e Hidrocentralit të Kalivaçit, është në ndërtim e sipër, por punimet aktualisht janë ndërprerë. Një kërcënim tjetër për këtë pellg ujëmbledhës është edhe Plani Grek i Menaxhimit, miratuar nga Qeveria Greke, ku parashikohet devijimi i një sasive të ujërave të lumit Vjosa drejt liqenit të Janinës. Projekte të tilla do ta shkatërrojnë këtë ekosistem lumor unik. Për më tepër, këto projekte bien ndesh me legjislacionin e BE-së si Direktiva Natura 2000 dhe Direktiva e Rrjetit të Ujërave.

Ne, OJF-të shqiptare të poshtëshënuara, kundërshtojmë fuqimisht projektet që çenojnë integritetin e lumit të Vjosës. Në vend të tyre, ne duam të mbrojmë trashëgiminë tonë natyrore. Vjosa nuk është vetëm një thesar natyror për Shqipërinë por edhe për të gjithë Evropën. Ky lum është një thesar i trashëgimisë kulturore dhe socio-historike të rajonit.

Ne kërkojmë, që Qeveria Shqiptare të angazhohet në mbrojtjen e këtij lumi duke ndaluar projektet e ndërtimit të digave si dhe duke kërkuar transparencë të plotë nga pala greke për marrëveshjet ndërshtetërore mbi lumenjtë. Vjosa duhet të mbrohet në të gjithë gjatësinë e saj për një bashkëjetesë harmonike mes shoqërisë, natyrës dhe shkencës.

Nënshkruar nga:



PPNEA

Protection and Preservation of Natural Environment in Albania

Kujtim Mersini, Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)



EcoAlbania

Olsi Nika, Drejtor ekzekutiv, Qendra EcoAlbania

IMIM

INSTITUTI MENAXHIMIT & INTEGRIMIT MJEDISOR
ENVIRONMENTAL MANAGEMENT & INTEGRATION INSTITUTE

Teuta Hoxha, Instituti Menaxhimit dhe Integritimit Mjedisor (IMIM)



Elvis Çela, Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER)



Simo Ribaj, Edukimi Social dhe Mbrojtja e Mjedisit (SEEP)



Lavdosha Ferruni, Shoqata e Bujqësisë Organike (SHBO)



Shkelqim Bylykbashi, Horizont European (Horizont EU)



Ermelinda Mahmutaj Drejtore Egzekutive (Qendra EDEN)



Rita Strakosha Koordinatore Qendra "Grupimi Ekolevizja"